



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

---

Numri i lëndës: 2020:122655

Datë: 27.06.2024

Numri i dokumentit: 05867589

KA.nr. 563/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arben Toska, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Kolegji Universum” OP me NUI 810640294 dhe seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqësojnë avokatët Fisnik Salihu, Visar Ramaj, Kushtrim Palushi dhe Mentor Hajdaraj me seli në rrugën “Major Mehmet Bushi”, zona perëndimore, H-6/5, në Prishtinë, kundër të paditurit Agjencia e Kosovës për Akreditim, Këshilli Shtetëror për Cilësi me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të aktit administrativ, jashtë seancës më 27 qershor 2024 mori këtë:

AKTVENDIM

Pezullohet procedura e konfliktit administrativ sipas padisë së paditësit “Kolegji Universum” OP me NUI 810640294, kundër të paditurës Agjencia e Kosovës për Akreditim – Këshilli Shtetëror për Cilësi, për shkak të anulimit të vendimit të KSHC-së Ref. 566/20D të datës 22.06.2020 të së paditurit.

ARSYETIM

Paditësi më 29.09.2020 ka ushtruar padi kundër të Paditurës me të cilën i ka kërkuar kësaj gjykate anulimin e vendimit me numër të KSHC-së Ref. 566/20D të datës 22.06.2020 të lëshuar nga i padituri.

Megjithatë Paditësi përmes parashtresës së datës 21.06.2024 e ka njoftuar gjykatën se e tërheq padinë e paraqitur më datë 29.09.2020, për këtë çështje të konfliktit administrativ.

Duke marr për bazë se sipas nenit 31 para.1 të LKA-së paditësi mund të heqë dorë nga padia derisa të mos merret vendimi dhe se në këtë rast gjykata e pezullon, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Gjykata sheh të arsyeshme të sqaroj se, në konfliktit administrativ,

sipas nenit të cituar më lartë, nuk kërkohet pëlqimi i të Paditurit për tërheqjen e padisë, rrjedhimisht nuk e mori mendimin e të Paditurit.

Për këto arsye gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata Komerciale e Kosovës

Dhomat e Shkallës së Parë Departamenti i Përgjithshëm

KA.nr.563/22

Gjyqtari

---

Arben Toska

UDHËZIMI PËR MJETIN E GODTIJES: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.